



**THIRRJA** *dhe*  
**THIRRËSI**

EBU HASEN NEDEVIJU

**Ebu-l-Hasen Ali El-Haseni En-Nedvi**

# **THIRRJA DHE THIRRËSI**

Përktheu:  
**Dr. Sedat Islami**

Prishtinë, 2018

*Titulli në origjinal:*

**Hikmetu ed-da'veti ve sifetu-d-duati**

*Autor:*

**Ebu-l-Hasen Ali El-Haseni En-Nedvi**

*Përkthyes:*

**Dr. Sedat Islami**

*Redaktor fetar:*

**Almedin Ejupi**

*Redaktor gjuhësor:*

**Jeton Koqinaj**

*Botues:*

**Shembulli**

ISBN: 978-9951-732-14-7

© Të drejtat e ribotimit janë ekskluzive për përkthyesin.

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                                   |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Në vend të hyrjes.....</b>                                                     | <b>7</b>  |
| <b>Thirrja dhe thirrësit .....</b>                                                | <b>13</b> |
| <b>Esenca e davesë - thirrjes islame .....</b>                                    | <b>14</b> |
| <b>Bashkëveprimi dhe fleksibiliteti, tipare të davesë.....</b>                    | <b>17</b> |
| <b>Dy shembuj nga histori profetësh mbi davenë.....</b>                           | <b>23</b> |
| Shembulli i parë: Tregimi i profetit Jusuf, paqja qoftë mbi të .....              | 23        |
| Shembulli i dytë: Trajtimi profetik i pakënaqësisë së një pjese të ensarëve ..... | 43        |
| <b>Dy faktorë që garantojnë suksesin në predikim dhe mision .....</b>             | <b>50</b> |
| Faktori i parë: Daveja të jetë besim, kredo dhe ide .....                         | 50        |

|                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------|----|
| Faktori i dytë: Ikja nga interesi dhe përfitimi material ..... | 54 |
| Rrëfimi i Ibn Tejmijes .....                                   | 55 |
| Rrëfimi i Hoxhës nga India .....                               | 55 |
| Rrëfimi i Hoxhës Seid El-Halebi.....                           | 57 |
| Përvoja e Hoxhë Ahmed Serhendit.....                           | 59 |

## Në vend të hyrjes

Kjo ligjëratë e mrekullueshme dhe me shumë vlerë është mbajtur në sallën e ligjëratave të Universitetit Islamik të Medinës së Profetit Muhamed, *lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të!*, më 17.4.1400 h., përkatësisht më 5.3.1980. Ligjërata është mbajtur me kërkesën e studentëve dashamirë drejtuar thirrësit dhe luftëtarit (të dijes), shkëlqesisë së tij hoxhë *Es-Sejjid Ebi-l-Hasen Ali El-Haseni En-Nedvit*, të cilët qenë përmalluar për dëgjimin e ligjëratave të tij. Kërkesa e tyre parashtruar autoriteteve të Universitetit për mundësimin e një takimi dhe ligjërata nga hoxha në fjalë u pranua pozitivisht.

Lajmi për këtë ligjëratë u përhap me shpejtësi në Universitet. Takimi ishte madhështor. Kishte studentë, profesorë dhe përgjegjës administrativë të Universitetit përkatës. Salla ishte e vogël për t'i zënë të gjithë ata që ishin tubuar për ta dëgjuar këtë hoxhë.

Manifestimin e udhëhoqi zv. rektori, ekselencia e tij dr. Abdullah Zajidi. Hapja solemne e manifestimit u bë me recitimin e ajeteve kuranore:

﴿إِنَّ إِبْرَاهِيمَ كَانَ أُمَّةً قَانِتًا لِلَّهِ حَنِيفًا وَلَمْ يَكُ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٢٠﴾  
شَاكِرًا لِّأَنْعَمِهِ اجْتَبَاهُ وَهَدَاهُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٢١﴾ وَآتَيْنَاهُ فِي  
الدُّنْيَا حَسَنَةً وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ ﴿١٢٢﴾ ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ  
أَنِ اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٢٣﴾ إِنَّمَا جُعِلَ  
السَّبْتُ عَلَى الَّذِينَ اخْتَلَفُوا فِيهِ وَإِنَّ رَبَّكَ لَيَحْكُمُ بَيْنَهُمْ يَوْمَ  
الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿١٢٤﴾ ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ  
وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ  
بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ ﴿١٢٥﴾ وَإِنْ عَاقَبْتُمْ

فَعَاقِبُوا بِيْثَلٍ مَا عُوْقِبْتُمْ بِهِ وَلَئِنْ صَبَرْتُمْ لَهُوَ خَيْرٌ لِلصَّابِرِينَ ﴿١٣٦﴾  
وَأَصْبِرْ وَمَا صَبْرُكَ إِلَّا بِاللَّهِ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ وَلَا تَكُ فِي ضَيْقٍ  
مِّمَّا يَمْكُرُونَ ﴿١٣٧﴾ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ ﴿١٣٨﴾

**“Me të vërtetë, Ibrahimimi ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përrulur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë nga idhujtarët, (por ka qenë) mirënjohës ndaj dhuntive të Tij. Ai e zgjodhi atë dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë. Ne i kemi dhënë atij të mira në këtë botë, ndërsa në botën tjetër, sigurisht që ai do të jetë nga të mirët. Pastaj ty të shpallëm: “Paso me sinjeritet fenë e Ibrahimit, që nuk ka qenë prej idhujtarëve.” Në të vërtetë, e Shtuna u caktua për ata që patën kundërshti në lidhje me të. Sigurisht që Zoti yt do t’i gjykojë ata në Ditën e Kiametit, për çështjet, që ata nuk pajtoheshin. Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe**



**diskuto me ta në mënyrën më të mirë!  
Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata  
që janë shmangur nga rruga e Tij, e di  
më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë.  
Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni  
ndëshkuar, por, nëse duroni, kjo është  
më e mira (rrugë) për të durueshmit.  
Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me  
ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo  
për ta e mos u ngushto për shkak të  
dredhive të tyre! Vërtet, Allahu është me  
ata që e kanë frikë dhe që janë  
punëmirë.” (En Nahl: 120-128)**

Ajetet shënuan hapjen më të mirë të  
mundshme të manifestimit, sepse  
tematika e tyre përputhej me tematikën e  
ligjëratës, e cila mbante titullin *“Urtësia e  
thirrjes dhe tiparet e thirrësve”*.<sup>1</sup>

Përkushtimi për dëgjimin e ligjëratës ishte  
i mahnitshëm. Ndërkaq, ende pa mbaruar

---

<sup>1</sup> Në shqip e kemi përshtatur: Thirrja dhe thirrësit.

ligjërata, spikatën efektet e para të saj: zemrat u zbutën e sytë lotuan. Hoxha dëshironte që të gdhendte në gjoksin e secilit student maksimën famoze të zotërisë sonë, Ebu Bekrit, *radijallahu anhu*: **Të gjymtohet kjo fe duke qenë unë gjallë?!**, që njëherazi ishte thelbi i tërë ligjërates dhe mesazhi kryesor i saj. Allahu e shpërbleftë hoxhën me mirësitë e Tij!

Ligjëraten e patën incizuar në versionin audio shumë studentë, ndërsa vëllai ynë, Muhamed Ridvan En-Nedvi, po ashtu student në Universitetin e Medinës, versionin audio e solli në version të shkruar.

Tani që ligjëruesi autor i ka hedhur një shikim dhe ka bërë ca ndryshime, ndihemi të privilegjuar që na është dhënë rasti ta botojmë edhe si format të shkruar, në mënyrë që të arrijë te një numër sa më i madh i të rinjve myslimanë. Kështu, libri

do të përfitonte më shumë lexues, sakaq mesazhi i tij: **Të gjymtohet kjo fe duke qenë unë gjallë?!**, do të ngelte e do të afirmohej si qëllim i jetës.

Allahu i di qëllimet tona dhe Ai udhëzon në rrugën e drejtë.

Botuesi

بسم الله الرحمن الرحيم

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëbërësit!*

## THIRRJA DHE THIRRËSIT

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve, ndërsa lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të Dërguarin, Muhamedin, familjen, shokët dhe pasuesit e tij!

*Ekselenca juaj, zv. rektor i Universitetit të Medinës,*

*Kolegë profesorë dhe edukatorë,*

*Bijtë e mi, studentë të zellshëm!*

## **Esenca e davesë - thirrjes islame<sup>2</sup>**

Ndër shembujt që qarkullojnë në literaturën e huaj është edhe ai se *dashuria dhe lufta nuk i nënshtrohen asnjë rregulli të shkruar e asnjë kufiri të caktuar*. Sa i përket *dashurisë*, atë po ua lë shkrimtarëve dhe poetëve, ata le ta hulumtojnë, kurse me *luftën* nuk dua të merrem fare, kështu që, në vend të këtij shembulli, që nuk përkon me frymën dhe idenë islame, do të marr një shembull, që njëherazi është një prej bazave (strategjike e vizionare), sipas të cilit *edukimi dhe daveja nuk i nënshtrohen asnjë rregulli të shkruar*,<sup>3</sup> ngase edukimi

---

<sup>2</sup> Të gjithë titujt, përveç titullit bazë të librit, janë vënë nga përkthyesi.

<sup>3</sup> Autori me këtë nuk ka për qëllim që edukimi dhe daveja të demonstrohen sipas tekave dhe qejfeve tona. Përkundrazi, ai kërkon që konceptet përkatëse të mos kufizohen në gjëra formale dhe të ngurta, që, siç do të shohim gjatë tekstit, i sheh si

është një sistem specifik dhe i veçantë. Nëse unë nënvlerësoj rëndësinë e aksh librarie të madhe që është shkruar për edukimin, ndërsa flas ose diskutoj për këtë temë, assesi nuk e nënvlerësoj kontributin e edukatorëve që kanë konsultuar përvojat praktike dhe programet edukative botërore. Ç'është e vërteta, synoj diç që kam shprehur në një manifestim të një prej fakulteteve të edukimit në një vend të madh arab: *"Kam bindjen se mësuesi nuk do të jetë mësues i vërtetë përderisa nuk do të jetë edhe i frymëzuar-i inspiruar"*, ndërsa këtu po shtoj se me *inspirim* (ar. *ilham*) nuk kam për qëllim domethënien terminologjike fetare, por edukimin që shpërthen intelektin, ndez talentet e dhuntitë dhe inspiron për domethëniet e largëta, nëse për to veç krijohen rasti dhe ambienti.

---

dëmtuese të imazhit të tyre dhe zhveshje nga roli thelbësor e primar i tyre.

Po ashtu, as daveja nuk mund t'i nënshtrohet një rregulli të vrazhdë të shkruar e të caktuar, të përpiluar nga njeriu apo hoxhallarët. Ai që provon t'ua nënshtrojë davenë apo duatët (thirrësit) një rregulli të caktuar apo një liste të caktuar titujsh, shënimesh dhe synimesh, mund të ndeshet me përvojë të hidhur dhe aspak të këndshme.

## **Bashkëveprimi dhe fleksibiliteti, tipare të davesë**

Në shoqërinë tonë qarkullon një rrëfim, që konsideroj se nuk ka gjë të keqe ta rrëfej edhe para jush.

*Një njeri i pasur kishte angazhuar një shërbëtor të zgjuar, i cili, që në fillim, i kishte kërkuar zotërisë që t'i përpilonte një listë me detyrat dhe obligimet që duhej t'i kryente dhe t'i përmbushte. Zotëria hëpërhë ia përpiloi listën: do ta bësh këtë e atë punë në këtë e atë kohë, do të shkosh në treg për të blerë gjërat e nevojshme për ushqimet ditore, si: mish, perime, zarzavate, dhe detyra të tjera, të cilat ia shkroi në listë. Shërbëtori e mori listën dhe e ruante me kujdes. Një ditë, ndërsa zotëria bëhej gati të shalonte atin, seç iu ndërthur këmba dhe për pak sa nuk u përplas përtokë.*



*Mundohej ta zgjidhte problemin vetëm, por nuk ia dilte. Kërkoi ndihmë nga shërbëtori, i cili, në vend se t'i ndihmonte, e nxori listën nga xhepi dhe tha: “Zotëri, më trego ku shkruan që unë duhet ta ndihmoj zotërinë tim nëse i ndërthuret këmba teksa hipën në kalë?” Përkundër këmbënguljes së zotërisë dhe rrezikut serioz për jetën, shërbëtori nuk e ndihmoi. Përkundrazi, i mbeti “besnik” listës së detyrimeve.*

Kam frikë se do ta dëmtojmë davenë, por edhe vetë shoqërinë, nëse do ta kushtëzohim dhe do ta interpretojmë me mendime moderne, apo me mendime praktike, të cilat janë rezultat i përvojës dhe natyrës së (trendit të) kohës apo mjedisit.

Fatbardhësisht, Allahu i Madhëruar, kundrejt këtij problemi, na ka bërë zgjidhje në Librin e Tij, në Kuranin

sfidues, në Librin e përjetshëm, Librin, risitë e të cilit nuk kanë të sosur dhe i cili ndjek vijën mesatare ndërmjet teprimit apo ekstremizmit dhe anashkalimit apo shpërfilljes. Allahu i Madhëruar thotë: [Ndërkohë<sup>4</sup> e falënderoj Allahun që hapja e këtij manifestimi rastisi të bëhet pikërisht me këtë ajet, gjë e cila është prej mrekullive të panumërta të Kuranit, e mrekullinë nuk mund ta marrë dot me mend ai që nuk e ka përjetuar. Kur Profeti ﷺ kishte vdekur, myslimanët e kishin përjetuar rëndë, madje disa e patën humbur vetëdijen, saqë Omeri, *radijallahu anhu*, kërcënonte me shpatë ata që pretendonin se Profeti ﷺ ka vdekur. Mu

---

<sup>4</sup> Këtu autori bën një shprehje, siç është rëndom traditë e dijetarëve të mëdhenj, e cila është, si të thuash, një lloj *hyrje* për të kuptuar rëndësinë e përjetimit të domethëniesve të ajeteve kuranore, për të vazhduar më pas me ajetin 125 nga kapitulli *En-Nahl*, të cilin e ka argument për idenë dhe mendimin e tij. Përkthyesi.

atëherë, vajti Ebu Bekri, *radijallahu anhu*, me ç'rast recitoi këtë ajet:

﴿وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ﴾

**“Muhamedi është thjesht një i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë...”** (Ali Imran: 144)

Në çast, sahabët, në mesin e të cilëve edhe sahabë të mëdhenj, shijuan kënaqësinë e këtij ajeti, hetuan madhështinë dhe prekën mrekullinë e tij. U dukej sikur ajeti po shpallej aty për aty. Ne, edhe po ta lexojmë qindra herë, nuk do të mund ta arrijmë kënaqësinë e tij dhe nuk do të përjetojmë atë ndjenjë të veçantë që e kishin përjetuar ata që ishin dëshmitarë të kësaj ndodhie të rrallë në historinë e popujve dhe feve.] Kështu është dhe ajeti:

﴿ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ﴾

**“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë!” (En Nahl: 125)**

Mund të vëreni mrekullinë në Fjalën e Allahut: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd...”**?

Mund të identifikoni dimensionet e përgjithësimit dhe përmasat e asaj që fillimisht ka ardhur në formë të kushtëzuar, për t’u përgjithësuar më pas: **“... në rrugën e Zotit tënd...”** Nuk ka përcaktuar as apostrofuar asgjë në mënyrë të veçantë. Së këndejmi, slogani **“... rrugën e Zotit tënd...”** përfshin thirrjen për të falur namazin, për t’u fisnikëruar me virtyte të larta morali, është një rrugë me një hapësirë të madhe, hapësirë që përfshin kërkesat e njerëzimit, hapësirë e jetës njerëzore. Mundohuni ta sillni ndërmend mrekullinë e plotë të këtij ajeti kuranor:

- **“... thirr...”** nuk përfshin vetëm hutben (ligjërimin) apo shkrimin (si

mjete a mënyra), sikur që nuk kufizohet vetëm në këshillim. Jo, përfshin të gjitha këto domethënie, mënyra e metoda të thirrjes.

- **“... në rrugën e Zotit tënd...”** Cila fjalë mund të ketë diapazon më të gjerë të kuptimit dhe përfshirjes se kjo fjalë?

Më duhet ta pranoj para jush se *hikmeh* - urtësia është një fjalë e rrallë retorike, të cilën nuk mund ta përkthejmë në asnjë gjuhë, është gjithëpërfshirëse. Të tilla janë edhe shprehjet *meuidhah* - këshillë dhe *haseneh* - e mirë. Këtu ndërhyt Kurani për të ofruar zgjidhjen e këtij problemi, duke përgjithësuar e kushtëzuar, duke përmbledhur e sfiduar (me domethëniet e tij prej mrekullish), ku thotë: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë!”** (En Nahl: 125)

## Dy shembuj nga histori profetësh mbi davenë

Kurani i madhërishëm është përplot shembuj të rrallë dhe të mahnitshëm të urtësisë në dave, shembuj që janë përjetësuar në historinë e njerëzimit dhe davesë. Mirëpo, për ilustrim, do të marrim vetëm dy shembuj, njërin nga Kurani, tjetrin nga historia dhe jetëshkrimi i Profetit tonë, Muhamedit ﷺ.

### Shembulli i parë:

Tregimi i profetit Jusuf, *paqja qoftë mbi të!*, që në mënyrë të detajuar rrëfëhet në kaptinën *Jusuf*. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَدَخَلَ مَعَهُ السِّجْنَ فَتَيَانٍ قَالَ أَحَدُهُمَا إِنِّي أَرَانِي أَعْصِرُ خَمْرًا وَقَالَ الْآخَرُ إِنِّي أَرَانِي أَحْمِلُ فَوْقَ رَأْسِي خُبْرًا تَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْهُ نَبِئْنَا بِتَأْوِيلِهِ إِنَّا نَرَاكَ مِنَ الْمُحْسِنِينَ﴾

**“Bashkë me Jusufin hynë në burg edhe dy djelmosha. Njëri prej tyre tha: “Unë kam parë (në ëndërr) veten, se si shtrydhja verë.” Tjetri tha: “Unë kam parë në ëndërr, se si mbaja në kokë bukë, të cilën e hanin shpendët. Shpjegona kuptimin e ëndrrave. Ne, me të vërtetë, shohim se ti je njeri i mirë.” (Jusuf: 36)**

Vëllezër!

Mund të paramendoni rrethanat dhe ambientin në të cilin gjendej kjo *thirrje*! Sigurisht, nuk ka qene punë e lehtë. Pikënisje ka një ambient të frikshëm, të errët, një rreth i cili paraqet një pengesë të fuqishme për realizimin e qëllimeve të larta që synonte Jusufi, *alejhis selam*. U burgos shkaku i një akuze për një vepër me motive të ulëta, ndërkohë pozita e njeriut të akuzuar është pozitë e brishtë. Ai nuk gëzon pozitën që gëzon një thirrës, emri i të cilit nuk është përfolur e as përbaltur. Ai, shprehur sipas një thënieje

të urtë arabe, edhe nëse është *i pastër nga ky mëkat siç është ujku i pastër nga gjaku i këtij* (Jusufit), megjithatë, akuza ishte drejtuar, gjykata kishte vendosur, ndërsa në popull ishte përhapur se Jusufi ka tradhtuar zotërinë e tij, duke e shkelur në nder. Këto gjëra zbehnin pozitën e tij, por, megjithëkëtë, kur Jusufi, *alejhis selam*, hyri në burg, ai, për të mirë, tërhoqi vëmendjen e njerëzve dhe shumë shpejt përfitoi zemrat e të tjerëve. Sigurisht, kjo ndodhi falë planifikimit dhe përcaktimit hyjnor.

Dy shokët e burgut, ndonëse nuk i kishte shokë dhe nuk ishin të kategorisë së tij, se Jusufi, *alejhis selam*, ishte fisniku, i biri i fisnikut (profetit Jakub), i birit të fisnikut (profetit Is'hak, *alejhimus selam*), ngase ata (të burgosurit) kishin bërë vepra të ulëta, megjithatë, meqë burgu i bashkonte, ata ishin shokë burgu. Që të dy kishin parë nga një ëndërr, ndërsa Allahu i Madhëruar ishte Ai që i inspiroi. Ata, me



përvojën dhe intuitën e tyre njerëzore, e kuptuan se në një apo formë tjetër ishin personazhe të këtyre ëndrrave, pra ato kishin të bënin me ta, ndaj i vetmi që mund të bënte interpretimin e ëndrrave në fjalë ishte Jusufi, ky që rishtazi kishte hyrë në burg, të cilit në fytyrë i shiheshin shenjat e ndershmërisë, singëritetit dhe prejardhjes së fisme e të shquar. Kështu, vajtën te Jusufi dhe secili prej tyre ia rrëfeu ëndrrën.

**“Njëri prej tyre tha: “Unë kam parë (në ëndërr) veten, se si shtrydhja verë.” Tjetri tha: “Unë kam parë në ëndërr, se si mbaja në kokë bukë, të cilën e hanin shpendët. Shpjegona kuptimin e ëndrrave. Ne, me të vërtetë, shohim se ti je njeri i mirë.” (Jusuf: 36)**

Kur citoj këtë ajet, dua të keni parasysh dy mësimet psikologjike që përfitojmë prej tij, të cilat, për nga pesha e përfitimit, fuqisë

dhe mbështetjes që na japin, tejkalojnë vlerën e njëqind librave:

- *së pari*, konfirmimi se Jusufi ishte kompetent për shpjegimin e lajmit për të cilin kishin vajtur për ta pyetur;
- (*së dyti*) ata nuk kishin gabuar kur i qenë drejtuar Jusufit. Ata kishin gjetur njeriun e duhur, i cili mund t'i udhëzonte. Në psikologji është vërtetuar se njeriu në nevojë ka dëshirë që sa më parë të përmbushë kërkesën e tij. Nëse një i sëmurë shkon për vizitë te një mjek i cili e zvarrit trajtimin e tij duke thënë: Shiko, do t'i referohem kësaj literature, do të konsultohem me këtë mjek në aksh qytet, që të mundohem të gjej shërimin për ty, - ai do të ndihet i zhgënjyer, do t'i humbë shpresa dhe, me gjasë,

kurrë nuk do ta rivizitojë mjekun në fjalë.

Gjëja e parë që duhet bërë është që ta sigurosh personin të cilin dertet dhe hallet e kanë sjellë te ti se, nuk e ka gabuar adresën dhe se ti do t'i ndihmosh që t'i zgjidhë problemet. Ai (Jusufi), *alejhis selam*, tha:

﴿قَالَ لَا يَأْتِيكُمَا طَعَامٌ تُرْزَقَانِهِ إِلَّا نَبَأُكُمَا بِتَأْوِيلِهِ قَبْلَ أَنْ يَأْتِيَكُمَا﴾

**“Jusufi tha: “Sa herë që t’ju vijë ndonjë ushqim (në ëndërr) si risk për ju, unë do t’ju lajmëroj se çfarë kuptimi ka, para se të bëhet realitet...” (Jusuf: 37)**

Pra, kjo nënkupton se çështja për të cilën pyesni, do të marrë përgjigjen së shpejti, ngase ata ishin brenda burgut dhe, detyrimisht, duhej t’u nënshtroheshin rregullave të tij, në mesin e të cilave edhe takimet e shkurtra me njëri-tjetrin. Kështu,

brenda këtij intervali kohor të qëndrimit, deshi t'i bindte dhe t'i qetësonte ata se së shpejti do të plotësonte kërkesën e tyre: **"... unë do t'ju lajmëroj se çfarë kuptimi ka, para se të bëhet realitet..."**

Ky ajet ka disa shpjegime:

*Shpjegimi i parë* ka të bëjë me vetë llojin e ushqimit. Kur Jusufi, *alejhis selam*, iu tha: **"Jusufi tha: "Sa herë që t'ju vijë ndonjë ushqim (në ëndërr) si risk për ju, unë do t'ju lajmëroj se çfarë kuptimi ka, para se të bëhet realitet..."**, për qëllim kishte të vërtetën e atij ushqimi, ose, më konkretisht, deshi që shokëve të tij t'ua mbillte vetëbesimin nëpërmjet informimit të tyre ose dhënies së lajmit për diç (natyrën, esencën, llojin e një gjëje) që ai nuk e ka parë më herët (nuk është informuar për të). Pra, për zgjodhi këtë gjë si mjet për të përfituar besimin e tyre.

Personalisht, nuk e miratoj një shpjegim të këtillë dhe nuk e shoh si të goditur për disa arsye: në ajet flitet për diç të fshehtë, sekrete, kurse në burg, zakonisht, nuk ka mundësi të përzgjidhen ushqimet, kështu që nuk do të ishte ndonjë punë e vështirë për t'ia qëlluar çfarë ushqimi do të kishte këtë apo atë ditë (pra ushqimi dhe llojet e tij nuk janë sekrete). Çfarë zgjuarsie apo shkathtësie do t'i jenë dashur zotërisë sonë, Jusufit, *alejhis selam*, që të ndiente se çfarë lloji i ushqimit do t'iu sillej?! Në Bibël (Dhiatën e Vjetër) thuhet se Jusufi, *alejhis selam*, ka qenë mbikëqyrës i ushqimit. Rrjedhimisht, nëse kjo mund të merret si e mirëqenë, atëherë nuk ka asgjë të jashtëzakonshme që mbikëqyrësi i ushqimit t'i informojë për llojin e ushqimit që do t'iu shërbehej.

Së këndejmi, unë anoj nga një shpjegim tjetër (*shpjegimi i dytë*), i cili gjendet në disa komentare të Kuranit, sipas të cilit qëllimi

në ajetin përkatës është se ata nuk kanë nevojë të qëndrojnë shumë tek ai dhe të ndiejnë monotoni aq sa të vijë edhe gardiani dhe t'i nxjerrë që andej apo t'i qortojë përse kanë shkuar, kush iu ka dhënë leje etj.

Vështruar nga perspektiva e ajetit, del se, krahas zhvillimit kulturor që ka pasur Egjipti i atëkohshëm, ka pasur edhe zhvillim administrativ, ndaj është më se normale që orari i ushqimit të ketë qenë i caktuar dhe se kur kishin vajtur të kërkonin interpretimin te Jusufi, *alejhis selam*, koha e ushqimit tashmë ishte afruar.

Ka dhe diç tjetër, që tani më ra ndërmend: lidhja ndërmjet të burgosurve dhe ushqimit është e fortë, kështu që, kur kishte përmendur ushqimin, ata qenë përmalluar, stimuluar dhe emocionuar që kishin dëgjuar tek bëhej fjalë për ushqimin. Nëse ushqimi është i dashur

për njerëzit në përgjithësi, për të burgosurit është edhe më i dashur, kështu që, kur Jusufi e kishte përmendur ushqimin, pati thënë: **“Sa herë që t’ju vijë ndonjë ushqim (në ëndërr) si risk për ju, unë do t’ju lajmëroj se çfarë kuptimi ka, para se të bëhet realitet...”**, ata përjetuan një ndjesi gjallërie, fituan energji dhe vullnet, ndaj u përgatitën të dëgjonin se për çfarë do t’i lajmëronte.

Pastaj, siç e do tradita dhe etika profetike, këtë mirësi nuk duhet atribuar vetes, respektivisht zgjuarsisë, inteligjencës, aftësive dhe shkathtësive personale, por për të i detyrohet Allahut të Madhëruar.

Këtu Jusufi, *alejhis selam*, bëri një hap apo veprim plot urtësi e të pashembullt, kur thotë:

﴿ذَلِكُمْ مِمَّا عَلَّمَنِي رَبِّي﴾

**“Kjo është prej diturive që m’i ka mësuar Zoti im...” (Jusuf: 37)**

Ishte një hyrje e mrekullueshme për këshillën të cilën donte ta jepte apo për predikimin që dëshironte të bënte. E shihni si kaloi nga komentimi i ëndrrave, madje ende pa e realizuar komentimin e tyre në tërësi, në thirrjen e urtë (detyrën profetike, misionin). Një fjalim i gjatë do të ishte i pakapshëm apo i papërballueshëm për këta dy të burgosur, që nevoja i kishte sjellë te Jusufi, *alejhis selam*. Ëndrrat u kishin shkaktuar makth. Ishin të trishtuar dhe shumë të frikësuar, andaj, në këtë gjendje, nuk mund të përballonin një fjalim të gjatë.

Jusufi, *alejhis selam*, për këtë shpjegim të shkurtër, porse të thukët dhe bindës, tha se nuk i detyrohej zgjuarsisë dhe aftësive të tij, por Allahut. Shfrytëzoi këtë mundësi ose pikëkalim për të depërtuar lehtë dhe gradualisht në atë që synonte: misionin.



Mund ta imagjinoni urtësinë e Jusufit, *alejhis selam*, në mision, ai nuk kishte mundësi t’u thoshte: Bëni durim, o vëllezër, apo o ju shokë të nderuar dhe fisnikë, sepse unë do t’jua komentoj juve ëndrrën, por më parë dëgjoni prej meje diç që është më me rëndësi dhe më me prioritet. Mendoni se do ta dëgjonin këtë të folur dhe ligjërime që nuk e kishin dëgjuar më parë dhe as që kishin vajtur për të? Ata kishin një hall tjetër. Jusufi, *alejhis selam*, pa bërë ndonjë shkëputje të gjatë, drejtpërdrejt iu drejtua dhe iu tha: **“Kjo është prej diturive që m’i ka mësuar Zoti im...”** (Jusuf: 37)

E shihni në ç’ambient u realizua kjo thirrje e urtë, së cilës nuk i gjej një shembull të vetëm jashtë veprimtarisë së Profetit tonë ﷺ, e prej së cilës, më tutje, do të shkëpus një insert. Nuk kam pasur rastin të lexoj në historinë e thirrjes apo të thirrësve një shembull kaq konciz dhe të

thellë sa ai i Jusufit, *alejhis selam*, i cili fillon fjalimin e tij me: **“Jusufi tha: “Sa herë që t’ju vijë ndonjë ushqim (në ëndërr) si risk për ju, unë do t’ju lajmëroj se çfarë kuptimi ka, para se të bëhet realitet...”**, për të kaluar më pas tek Allahu, te besimi monoteist: **“Kjo është prej diturive që m’i ka mësuar Zoti im...”**

Nuk mund të ketë një kalim nga një çështje në tjetrën në mënyrë kaq të lehtë, graduale, të shpejtë dhe me efekt sesa ky i Jusufit, *alejhis selam*! Ai sikur u thoshte: Nuk do të mund t’i komentoja këto ëndrra, se jam një njeri i pafuqishëm, që, madje, nuk mund ta kisha në dorë as fatin tim, ngase nuk munda të sprapsja ata që më futën në burg. Atëherë, një njeri që nuk ka pasur rrugëdalje tjetër para vendimit për ta futur në burg vetëm se të dorëzohej, si ka mundësi që vetvetiu të arrijë deri në këtë nivel të lartë të dijes?!

Jo, **“Kjo është prej diturive që m’i ka mësuar Zoti im...”**

Jo vetëm kaq, Jusufi, *alejhis selam*, vazhdoi me një pyetje tjetër: “Përse më ka mësuar Zoti im?”, për të bërë një tjetër ndërrim teme. Është një udhëtim i gjatë në rrugën e davesë. Rrugën që shumë thirrës, dijetarë dhe filozofë nuk mund ta përshkojnë për vite, Jusufi, *alejhis selam*, me urtësinë, lartësimin shpirtëror, zemrën e ndriçuar dhe idenë e qartë dhe të çiltër fetare e përshkoi për një moment: **“Kjo është prej diturive që m’i ka mësuar Zoti im. Unë e kam flakur fenë e njerëzve që nuk besojnë Allahun e që mohojnë jetën tjetër.”** (Jusuf: 37)

Pas kësaj, Jusufi, *alejhis selam*, ndjeu se tanimë ishte në një pozitë të fuqishme e të lartë, ndjeu sikur ka hipur në një kodër apo rrafshnaltë të lartë, andaj tha:

﴿يَا صَاحِبِ السِّجْنِ أَأَرْبَابٌ مُتَّفَقُونَ خَيْرٌ أَمِ اللَّهُ الْوَاحِدُ  
الْقَهَّارُ﴾

**“O shokët e mi të burgut! A janë më mirë një mori zotash të ndryshëm apo Allahu, i Vetmi, Ngadhënjimtari?” (Jusuf: 39)**

Po t’ua thoshte këtë fjali në fillim, do t’iu vinte e rëndë dhe e vështirë, kurse tani që po u thoshte: **“O shokët e mi të burgut! A janë më mirë një mori zotash të ndryshëm apo Allahu, i Vetmi, Ngadhënjimtari?”**, pasi ka ndërmarrë masat paraprake, po del të jetë me vend dhe e pranueshme.

Shikoni këtë strukturim fjalësh, këtë radhitje të mrekullueshme kuranore, radhitje përplot urtësi. Po ta vazhdonte bisedën Jusufi, *alejhis selam*, ajo do të teprohej, do të ishte e pështjellë, kështu që, kur kuptoi se ishte i fortë, në një pozitë të fortë, se ata ishin të përkushtuar për ta dëgjuar dhe se ata tanimë ishin gati për të

dëgjuar zërin që vjen nga qielli, sepse, në fakt, thirrja e tij ishte thirrje e Allahut drejtuar robërve të Tij, realizuar nëpërmjet lajmëtarëve dhe të dërguarve, kështu që iu tha shokëve të vet: **“O shokët e mi të burgut! A janë më mirë një mori zotash të ndryshëm apo Allahu, i Vetmi, Ngadhënjimtari?”**

Kësaj radhe toni ishte më i fuqishëm. Herën e parë ishte i butë, i lehtë, kurse tani i fuqishëm, i vrullshëm, energjik, plot jetë dhe besim. Kjo ishte mënyra më e lehtë për t'i bërë ata të kuptonin. Përndryshe, sikur të përdorte fraza logjike e filozofike, nuk do të kishin mundësi ta kuptonin.

Pastaj iu tha:

﴿مَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا أَسْمَاءَ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ﴾

**“Ata që ju i adhuron në vend të Allahut, janë vetëm emra, të cilët i keni vënë ju dhe të parët tuaj, pa pasur prej Tij asnjë argument...” (Jusuf, 40)**

Idhujt që adhurojnë, thjesht janë emra të fantazuar, emra për gjëra që në realitet nuk ekzistojnë, emra të grekët, emra të brahmanistët idhujtarë, emra edhe të tjerët të ngjashëm me ta. Mrekullia kuranore qëndron në atë se, Kurani i quajti “emra”, dhe kushdo që lexon në historinë e feve dhe historinë e mitologjisë, mund ta kuptojë nga afër se idhujt nuk janë tjetër vetëm se emra. Ndryshe, ku janë zotat?!

Ku janë zoti i shiut, zoti i luftës, zoti i dashurisë, i bukurisë?!

Ku janë këta zota?!

Ata janë të pranishëm vetëm në iluzion, janë vetëm emra bosh, të thatë, emra që i

keni emërtuar ju dhe prindërit tuaj pa pasur kurrfarë argumenti.

Ky ajet kuranor vazhdon të jetë mrekulli dhe sfidë deri në amshim. Idhujt janë vetëm emra. Ata janë zbuluar nga Kurani me këto fjalë: “... **janë vetëm emra, të cilët i keni vënë ju dhe të parët tuaj...**” (Jusuf: 40)

Atëherë, kur Jusufi, *alejhis selam*, kuptoi se kishte mbushur boshllëkun që kishte gjetur në zemrat e tyre, kuptoi se nuk ishte urtësi që të zgjaste fjalimin dhe të zgjerohej rreth teuhidit (monoteizmit). Mjeku specialist e di mirëfilli çfarë i duhet pacientit, sa janë të vlefshme barërat dhe deri në ç’masë duhen dhënë atij.

Kjo është metoda e thirrësit të inspiruar, thirrësit të mbështetur nga Allahu. Jusufi, *alejhis selam*, kuptoi se kishte ardhur në një stad të cilin nuk duhej ta kalonte dhe, mu për këtë shkak, ata që i vënë rregulla të

caktuara apo të prera davesë dhe edukimit, u hyjnë në hak (u bëjnë padrejtësi) atyre, gjegjësisht kufizojnë diapazonin dhe hapësirat e tyre, i privojnë prej lirive që kanë, ua zbehin gjallërinë. Ata, me këto rregulla, u bëjnë padrejtësi edhe thirrësve. Për këtë shkak, kur Jusufi, *alejhis selam*, kuptoi se nuk ishin të gatshëm të dëgjonin më shumë, u mjaftua me kaq, për të vazhduar me komentimin e ëndrrave.

Kjo pjesë kuranore shpalos dhe prezanton në imazhet më të mira të mundshme bukurinë e Jusufit, *alejhis selam*, bukurinë e vërtetë, (bukurinë) shpirtërore, intelektuale, profetike.

Megjithëqë kjo pjesë është mrekulli më vete dhe sfiduese, Dhiata e Vjetër nuk e ka përmendur fare. Kur kam krahasuar rrëfimin e Jusufit, *alejhis selam*, në Kuran dhe në Dhiatën e Vjetër, kam mbetur i çmeritur se si kjo, që është jo vetëm pjesa



më e bukur fetare, por edhe letrare, nuk figuruaka fare!

Në Dhiatën e Vjetër gjen numra, shifra e hapësira, por po i hyre fund e krye, në të nuk mund ta gjesh këtë insert madhështor. Aty flitet për arkivolin se ka qenë i madh kaq e aq metra, për rrobat se kanë qenë kështu e ashtu, se i janë shqyer e grisur ato nga kjo e ajo anë, por jo edhe për këtë pjesë, që u bën magji shpirtrave dhe që frymëzon për domethënie e botëkuptime. Kjo pjesë madhështore paraqet një shembull të përkryer të thirrjes në Kuranin famëmadh.

## **Shembulli i dytë:**

Do t'jua rrëfej edhe një shembull tjetër madhështor.

Siç e dini dhe siç keni lexuar në sire, plaçkën e fituar nga Beteja e Hunejnit Profeti ﷺ e kishte shpërndarë. Fisnikëve kurejshë iu pati dhënë shumë. Ebu Sufjanit, Ikrimë ibn Ebu Xhehlit dhe disa të tjerëve iu dha shumë, kurse ensarët (medinasit) morën relativisht pak krahasuar me të parët. Kjo ishte bërë duke u mbështetur në atë se kishin besim të fortë, se e donin dhe kishin lidhje të forta me Islamin dhe Profetin ﷺ, kështu që nuk kishin nevojë t'u përforcoheshin zemrat me pasuri.

Disa djem të rinj nga radhët e ensarëve thanë: “Profeti i veçoi pjesëtarët e fisit të tij me hise më të madhe të plaçkës dhe presë së luftës.” Këto fjalë i shkuan Profetit ﷺ, kështu që u mor me to, sepse nuk ishte

vetëm Profet, por edhe edukator. Urdhëroi të tuboheshin ensarët në një vend dhe kërkoi që, përveç tyre, askush të mos ishte i pranishëm. Pasi u tubuan, iu drejtua: “Çfarë janë këto fjalë që më kanë arritur dhe kjo pakënaqësi që po ndieni ndaj meje?”

U turpëruan, ndaj thanë: “Asgjë, o i Dërguari i Allahut, janë disa djem të rinj, të cilëve djalli iu ka bërë vesvese.”

Profeti ﷺ iu tha:

*“A nuk ju gjeta të paudhë e Allahu ju udhëzoi përmes meje?! A nuk ju gjeta të varfër e Allahu ju pasuroi përmes meje?! A nuk ju gjeta të përçarë e të hasmuar ndërmjet vete e Allahu jua bashkoi zemrat përmes meje?!”*

Po, o i Dërguari i Allahut. Allahut dhe të Dërguarit të Tij u takojnë meritat dhe lavdi (për këto punë), - iu përgjigjën.

Profeti ﷺ nuk nxitoi të fliste, përkundrazi, donte t'iu fliste me gjuhën e tyre, kështu që, duke dashur t'ua ngjallte ndjenjat njerëzore dhe t'i inspironte për botëkuptime madhështore, iu tha:

*“A nuk do të më përgjigjeni, o ensarë?”*

E si të të përgjigjemi, o i Dërguari i Allahut, kur Allahut dhe të Dërguarit të Tij u takojnë meritat dhe lavdi?, - i thanë.

Tha: *“Betohem në Allahun se, po të më thoshit: ‘Na ke ardhur i përgënjeshtroar, e të besuam, i pafuqishëm, e të ndihmuam, i përzënë, e të strehuam, i varfër, e të ngushëlluam’, do ta thoshit të vërtetën dhe atë do t’jua konfirmoja edhe unë.*

Sa lider, prijës e edukator i madh!

Cili lider mund të marrë kurajën e të dëshmojë për veten ashtu siç kishte bërë i Dërguari i Allahut ﷺ?!

Betohem në Allahun se, po qe se këto fjalë të mos na përcilleshin në mënyrë autentike në librat e biografisë profetike dhe në koleksionet autentike të haditheve, respektivisht në mënyrë të përmbledhur në *Sahihun e Buhariut* dhe në mënyrë më të zgjeruar në librin *Zadu-l-mead*, nuk do t'i takonte asnjë myslimani që t'i thotë këto fjalë: “... na ke ardhur i përgënjeshtuar, e të besuam, i pafuqishëm, e të ndihmuam, i përzënë, e të strehuam, i varfër, e të ngushëlluam.”

Pasi i bëri të lotonin dhe ua hoqi drynat që ua kishin mbyllur zemrat, iu drejtua:

“O ensarë!

*A më jeni hidhëruar për shkak të një plaçke të dynjasë, me të cilën desha të përfitoja zemrat e disa njerëzve, që ta pranonin Islamin, ngase për Islamin tuaj (vendosmërinë tuaj në fe) rri i qetë dhe i sigurt?”*

Shihni se si i bëri të ndiejnë një vetëbesim në shpirtrat e tyre, i cili mjaftonte për të stopuar çdo gjë që mund t'ua njolloshte shpirtrat, po qe se do të kishte pasur diçka të tillë, dhe iu tha:

*“A më jeni hidhëruar për shkak të një plaçke të dynjasë, me të cilën desha të përfitoja zemrat e disa njerëzve, që ta pranojnë Islamin, ngase për Islamin tuaj (vendosmërinë tuaj në fe) rri i qetë dhe i sigurt?”*

Pastaj tha një fjalë madhështore dhe të fuqishme, e cila nuk ndodh të dalë nga një gojë e të mos shpërthejnë lumenjtë, të mos çahen kodrat dhe të mos ndodhin mrekullitë:

*“O ensarë!*

*A nuk dëshironi që, ndërsa njerëzit kthehen nëpër vendqëndrimet e tyre me dele e deve, ju të ktheheni me të Dërguarin e Allahut ﷺ?!*

*Ju betohem në Allahun se, po të mos ishte hixhreti, do ta llogarisja veten ensar (medinas) dhe, ndërsa (të gjithë) njerëzit po të ndiqnin një rrugë dhe luginë, porse ensarët do të ndiqnin rrugë dhe luginë tjetër, do të ndiqja rrugën dhe luginën e ensarëve. Ensarët janë sikur këmisha e brendshme<sup>5</sup>, kurse të tjerët janë sikur rroba sipërfaqësore.”*

*O Allahu im, mëshiroji ensarët, bijtë e ensarëve dhe nipërit e tyre!”*

Tani që jam në qytetin e ensarëve (Medinë), nuk gjej shprehje dhe lutje më të bukur sesa të përsëris lutjen:

*“O Allahu im, mëshiroji ensarët, bijtë e ensarëve dhe nipërit e tyre!”*

---

<sup>5</sup> Kjo shprehje, siç shpjegon imam Neveviu, është përdorur figurativisht, duke dashur të tregojë afërsinë e tyre me të Dërguarin, ashtu siç është e ngjitur për trupi ndërresa e brendshme. Ensarët janë elita dhe të veçantët. Përkthyesi.

Çfarë ndodhi më pas dhe cili ishte rezultati?

Sigurisht, rezultati ishte ai që pritej natyrshëm. Sytë e tyre lotuan aq shumë, saqë iu lagën edhe mjekrat dhe thanë: “Jemi të kënaqur me të Dërguarin e Allahut ﷺ, si shpërblim dhe hise (kundrejt plaçkës së luftës)!”

Betohem në Allahun se, po të hulumtonim në literaturën e popujve dhe feve, ndërkohë unë, krahas arabishtes dhe gjuhës sime mëmë, gjuhës urdu, kam përvojë me hulumtime edhe në gjuhë të tjera, nuk do të gjenim këshillë më mbresëlënëse se kjo këshillë, ashtu siç nuk do të gjenim trajtim më të thellë dhe më të saktë shkencor të natyrës njerëzore se ky që ka bërë shkenca profetike!

Këta dy shembuj janë shembujt më të përkryer që janë regjistruar në historinë e literaturës dhe bibliotekave njerëzore.



## **Dy faktorë që garantojnë suksesin në predikim dhe mision**

Vëllezër!

Gjërat që garantojnë suksesin në fushën e davesë numërohen në gishtërinj dhe, ngaqë kohën e kam të kufizuar, do t'i përmbledh në dy shkaqe apo faktorë kryesorë:

**Faktori i parë:** Që t'ia kesh idenë, e cila duhet të të pushtojë e të qarkullojë në qenien tënde ashtu siç të qarkullon gjaku në trup, të mishërohet me qenien tënde... Vetëm kështu një thirrës mund të bëhet thirrës i suksesshëm, i frymëzuar, i ndihmuar dhe i përkrahur nga Allahu. Thirrësi i tillë nuk dështon!

Pra, kushti i parë është që daveja të mos jetë industri, zeje, art, zhdërvjelltësi dhe vetëm talent për të folur e ligjëruar; daveja patjetër duhet të jetë këdo dhe ide

(bindje), besim që pushton njeriun në çdo cep të qenies së tij duke e bërë që, edhe po të donte, të mos ketë mundësi të ndahet prej saj. Kështu ka qenë puna me zotërinë tonë, Ebu Bekrin, *radijallahu anhu*, në *Ditën e Riddës*, ditën kur njerëz filluan të largoheshin nga feja. A mund ta sillni ndërmend fjalën e përrjetshme që tha Ebu Bekri, *radijallahu anhu*, fjalën që ndryshoi rrjedhën e historisë?

Në përmbyllje të Konferencës së Parë Aziatike Islame të mbajtur në Karaçi, Pakistan, në të cilën morën pjesë mendimtarë të shquar dhe politikanë e liderë nga bota islame, u kërkuar prej meje të mbaja fjalën e fundit. Duke pasur parasysh nivelin e lartë intelektual dhe politik të pjesëmarrësve, këtë fjalë madhështore (të Ebu Bekrit) e mora për mbështetje dhe thashë: Cila është ajo fjalë (porosi, ide) kryesore që këta pjesëmarrës të kësaj konference do ta marrin në

përmbyllje të saj? Iu thashë: Fjala që do ta bartni me vete nga kjo konferencë është ajo që kishte thënë Ebu Bekri ditën kur njerëzit filluan ta braktisin fenë dhe të refuzojnë dhënien e zekatit: **Të gjymtohet kjo fe duke qenë unë gjallë?!**

Vëllezër studentë!

Ju jeni përgjegjës para Allahut!

O bijtë e mi, rini e myslimanëve dhe arabëve!

Ju jeni përgjegjës para Allahut! Keni mësuar në këtë universitet të bekuar, e ç'vend mund të jetë më afër shkollës së të Dërguarit ﷺ dhe suffës<sup>6</sup> së xhamisë së tij ku kanë mësuar sahabët e mëdhenj, duke nxënë përmendsh dhe duke mësuar ajkën

---

<sup>6</sup> Suffe është quajtur një hapësirë e Xhamisë së Profetit ﷺ, ku qëndronin sahabë që i përkushtoheshin adhurimit dhe kërkimit të dijes, bie fjala, Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, siç citon autori, etj.

e kuptimeve të tyre nga Profeti ﷺ? Në këtë shkollë diplomuan sahabë si Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, transmetuesi i njohur i haditheve dhe emblema e dijes fetare.

Cili universitet mund të jetë më afër kësaj shkolle profetike sesa universiteti juaj?!

E shihni se prej çfarë universiteti (madhështor) ne presim të diplomohen thirrës që veten ia falin thirrjes dhe misionit!

Ju betohem në Allahun se, po të kisha mundësi që këtë fjalë ta gdhendja në gjoksin e secilit prej jush, do ta bëja!

Ah, sikur në çdo shtëpi të kishte një pikturë apo tablo të madhe me mbishkrimin:

**Të gjymtohet kjo fe duke qenë unë gjallë?!**

**Faktori i dytë:** Ikja nga interesi dhe përfitimi material. Kjo nënkupton të mos kesh ambicie për të përfituar të mira materiale nga thirrja ose misioni yt. Kjo konsiston me një lloj asketizmi, jo sikur ai i krishterë, sepse në Islam nuk ka asketizëm ose murgëri. Allahu ka thënë:

﴿وَرَهْبَانِيَّةً ابْتَدَعُوهَا مَا كَتَبْنَاهَا عَلَيْهِمْ إِلَّا ابْتِغَاءَ رِضْوَانِ اللَّهِ﴾

**“Sa për murgërinë, Ne nuk ua urdhëruam atë, por ata e shpikën vetë për të arritur kënaqësinë e Allahut...”** (El-Hadid: 27)

Megjithëkëtë, daveja ka nevojë për krenari, vullnet të lartë, zhveshje nga lakmia dhe heqje dorë nga postet dhe pozitat e larta. Nëse ata të cilëve ua drejtoni ftesën ju shohin tek u bëni konkurrencë në pushtet dhe pasuri, do të dyshojnë në sinqeritetin tuaj dhe, për pasojë, do t’ju shpallin luftë. Kështu, bëjuani me dije se ju nuk kërkon

pushtetin, nuk synoni famën apo popullaritetin, nuk jeni njerëz të luksit e pasurisë, aq më pak të jeni të shtyrë në këtë rrugë nga lakmia e kureshtja për pasuri.

### **Rrëfimi i Ibn Tejmijes**

I ishte thënë shejhulislam Ibn Tejmijes: “Për ty po flitet që e do pushtetin.”

Nga habia, reagoi fuqishëm e tha: “E dua pushtetin?! Beto hem në Allahun se, tërë pushteti i tatarëve (që atëbotë ishte fuqia më e madhe në tokë) tek unë nuk ka vlerë as sa një dërrhem!”

### **Rrëfimi i Hoxhës nga India**

Një edukatori të rrallë të Indisë, të cilin Allahu e kishte bërë sepër për udhëzimin e shumë njerëzve, mbreti i Delhit i ofroi

një shumë marramendëse të hollash, të cilat ia kishte refuzuar.

“Medoemos duhet të pranosh diç prej kësaj që Allahu më ka dhënë mua”, - ia ktheu mbreti.

Hoxha iu përgjigj: “Allahu thotë:

﴿قُلْ مَتَاعُ الدُّنْيَا قَلِيلٌ﴾

**“Thuaju: “Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla.”** (En Nisa: 77)

Kësisoj, nëse tërë dynjaja është një pasuri e paktë, atëherë Azia është edhe më e paktë, India edhe më e paktë, pastaj Delhi edhe më e paktë. Andaj, ti, që nuk posedon më shumë se këtë pakicë, si mendon se unë do të marr pjesë nga kjo gjë e paktë dhe e pavlerë?!”

## **Rrëfimi i Hoxhës Seid El-Halebi**

Dua t'jua rrëfej një tregim, i cili ka ndodhur në Damask. Hoxhë Seid El-Halebi ishte hoxhë dhe edukator i madh i shekullit të kaluar. Një ditë, teksa po mbante një ders në xhami, i vajti Ibrahim Pashai, valiu gjeneral i Sirisë, i cili ishte i rreptë dhe i dhunshëm. Meqë hoxha ishte i sëmurë, respektivisht ndiente dhimbje në këmbë, e kishte zakon që ta mbante të shtrirë. Kur shkoi Ibrahim, hoxha kishte shtrirë këmbën dhe ishte i mbështetur në mihrab. Me Ibrahim Pashain ishin edhe ushtarakët dhe policia. Ibrahim Pashai priti që hoxha do ta mblidhte këmbën, gjë që nuk e bëri. Nxënësit përreth u frikësuan se Ibrahim do t'i hakmerrej duke ia prerë kokën për këtë gjest, ndaj mblodhën rrobat e tyre që të mos i spërkaste gjaku i pastër i hoxhës. Ibrahim Pashai qëndroi në këmbë për një kohë, pastaj u kthye. Më vonë dërgoi një



shërbëtor të tij me një qese me para të dukatit. Shërbëtori vajt te hoxha dhe i tha: Këto para janë dhuratë nga Pashai për ju. Hoxha i refuzoi dhe tha një fjalë që flet më shumë se një mijë poezi: *“Thuaji zotërisë tënd se ai që shtrin këmbën, nuk e shtrin dorën!”*

Njeriu është i lirë të zgjedhë: ose ta shtrijë këmbën, ose ta shtrijë dorën, porse nuk ka mundësi t’i shtrijë të dyja përnjëherë.<sup>7</sup>

Njerëzit natyrshëm e duan atë që nuk ua do paratë dhe e urrejnë rivalitetin në pasuri dhe gjërat që lakmojnë. E tillë është natyra e njeriut, tash e mijëra vite, dhe vazhdon të jetë e tillë. Nëse dëshironi të ndikoni tek ata që i thërrisni në fe, atëherë bëjuani me dije dhe qetësoni se ju nuk jeni kërkues të pushtetit e të parasë, të

---

<sup>7</sup> Shtrirja e këmbës në këtë kontekst simbolizon krenarinë dhe pavarësinë nga pushtetarët, kurse shtrirja e dorës lypjen dhe nënshtrimin. Përkthyesi.

leadershipit e të famës, të pozitive e të posteve. Tregojuni atyre se këtë po e bëni në shenjë mëshire, mirësjelljeje dhe butësie ndaj tyre, si dhe po e bëni nga frika që ata të mos i godasë ndonjë e keqe a ligësi.

### **Përvoja e Hoxhë Ahmed Serhendit**

Unë jam një student modest i historisë së reformimit dhe rilindjes, por, personalisht, ndonëse kam shumë fusha veprimi e hobe, në krye të tyre e kam historinë, veçmas atë të reformimit dhe rilindjes. Gjatë këtyre shekujve të fundit, sidomos pas shekullit VIII hixhrij, nuk kam parë ndonjë përvojë më të suksesshme se ajo e hoxhë Ahmed Serhendit nga India, rrëfimin e të cilit mund ta gjeni e ta lexoni hollësisht në vëllimin e katërt të librit tim *Rixhalu-l-fikri ve-d-da'veti*.

Në këtë tregim do të gjeni një hero-protagonist të zhveshur nga çdo armë dhe

mbështetje materiale, hero pa ushtri e ushtarë, që arriti të ndryshojë rrjedhën e një prej perandorive më të mëdha pas Perandorisë Osmane, perandorisë së madhe të mongolëve, e cila udhëhiqej nga mbreti i fuqishëm dhe i suksesshëm Xhelaluddin Ekber. Ky perandor, siç kam shpjeguar në ligjëratën time *Asifetun juvaxhihuha el-alem el-islamijj ve-l-arabijj*, në po këtë universitet, ishte rritur me urrejtjen dhe armiqësinë për Islamin, për shkak se, *ai që devijon pas Islamit dhe rebelohet ndaj tij, është më i keq dhe më armiqësor se ai që është rritur e zhvilluar në kufër (mohim), si dhe ai që del nga drita në errësirë, sheh më dobët se ai që është rritur e zhvilluar përherë në errësirë, pastaj (ç'është më e keqja) ai preket nga kompleksi i inferioritetit.*

Perandori Xhelaluddin ishte rritur duke u ushqyer me ndjenjën e urrejtjes dhe

armiqësisë kundër Islamit dhe, si shembuj konkret për këtë, do të merrija:

- faktin se askush në pallatin e tij nuk guxonte ta quante fëmijën me emrin Muhamed, ngase e urrente këtë emër;
- ndëshkonte me vrasje çdokënd që therte lopë<sup>8</sup>;
- kishte hapur lokale për konsumim të alkoolit dhe i nxiste njerëzit ta bëjnë një gjë të tillë;
- e hante mishin e derrit

... me një fjalë, ishte ndikuar nga hinduizmi dhe politeizmi, aq sa mbretërinë dëshironte ta çonte drejt një mbretërie me sfond hinduist e brahmanist dhe me një filozofi të vjetër indiane.

---

<sup>8</sup> Për shkak të ndikimit nga hinduizmi, ku lopa konsiderohet e shenjtë! Përkthyesi.

Për t'ia ndalur hovin kësaj rryme dhe për ta sfiduar këtë bela të madhe, Allahu i Lartësuar kishte përzgjedhur hoxhë Ahmed Serhendin (971-1034 h.), i cili që ulur në një qoshe të shtëpisë së tij dhe pati filluar të mendonte si ta ndalonte këtë të keqe të madhe. Filloi t'u shkruante mbretit dhe oborrtarëve të tij, ministrave dhe princave, duke i lëvduar dhe duke provokuar e ngjallur trimërinë, bujarinë, zemërgjerësinë, entuziazmin, zellin, shpirtmadhësinë islame dhe krenarinë fetare. Iu shkruante: "O trima! Ju jeni myslimanë, të bijtë e myslimanëve! Allahu ju ka nderuar me mirësinë e Islamit dhe, megjithëkëtë, në këto vende që janë çliruar nga myslimanët, vazhdojmë të shohim tek poshtërohen pasuesit e Muhamedit, të dashurit të Allahut: derdhet gjaku i tyre i pastër dhe ikin mendjet e ndritura dhe dijetarët e tyre, ndërkohë në tërë këtë ju jeni thjesht spektatorë. Si mund ta duroni

një gjë të tillë? Si mund të pajtoheni me këtë, o robër të Allahut?”

Vite me radhë vazhdoi me këto letra duke ua provokuar thelbin e besimit, duke ua vënë në lëvizje shtytësin e besimit islam, që gjendet thellë në zemrën e çdo myslimani. Pas një kohe, fitoi miq e simpatizantë nga radhët e princërve, madje këta u bënë nxënës të tij. Xhelaluddini vdiq e, pas tij, në fron erdhi i biri, Nuruddin Xhehankiri, i cili e ftoi hoxhën në pallat. Kur vajti, hoxha theu rendin që ishte për t'i bërë mbretit sexhden në shenjë nderimi. Për këtë u burgos dy vjet, e më pas ishte liruar e i ishte bashkëngjitur kampit ushtarak. Mbretin e shoqëroi tre vjet, kohë kjo e mjaftueshme për t'ia ndryshuar mendjen mbretit. Ai e kuptoi se hoxhë Ahmedi ishte i një kalibri tjetër, hoxhë i singertë dhe i edukuar, asket dhe vullnetmirë, kështu që filloi ta donte e ta respektonte.

Filloi të interesohej edhe për fenë, respektivisht ritet fetare, ndërtonte xhami në vendet që i çlironte, sakaq dashurinë e tij ndaj Islamit dhe myslimanëve e shfaqte hapur.

Hoxhë Ahmedi mbante lidhje të rregullta me ministra dhe princër, derisa arriti të formonte një elitë personalitetesh që kishin xhelozi fetare, elitë kjo që ndryshoi rrjedhën, jo vetëm të perandorisë, por edhe të vetë historisë. Xhenakiri ishte më i mirë se babai i tij, Ekberi, ndërsa i biri, Shah Xhahani, ishte edhe më i mirë se babai. Një fakt që e dëshmon këtë është se, kur mori pushtetin, ia sollën fronin e palluas<sup>9</sup>, për të cilin kishin shpenzuar miliona. Qëndroi një çast në të, e pastaj

---

<sup>9</sup> *Froni i palluas* ishte një traditë e mongolëve të mëdhenj në Indi. Më pas është bartur si traditë e familjeve mbretërore në Iran. Ka marrë emrin e palluas për shkak të zbukurimeve që bëheshin sikur të ishin me penda të palluas. Përkthyesi.

tha: “Sa i marrë që ka qenë Faraoni! Ai u ul në fronin e zi<sup>10</sup>, ndërsa pretendoi hyjninë e tha: “Unë jam Zoti juaj suprem.”<sup>11</sup> Unë nuk them ashtu, sepse jam mysliman.”

Pastaj zbriti nga froni, bëri një sexhde në shenjë falënderimi për Zotin, e u ul prapë në fron.

Pas tij erdhi Urenk Zib Alemkiri (Aurangzeb Alamgir), përkatësisht ai që kishte dhënë urdhrin të përmbledheshin në një libër fetvatë e dijetarëve indianë (el-fetava el-hindijeh), zbatoi normat fetare, kurse hindusëve ua obligoi xhizjen. Ishte një ndër mbretërit që e kuptonte fenë më së miri, ishte më xhelozi për të dhe më kureshtari ta pasonte traditën profetike.

---

<sup>10</sup> Fron i punuar nga dru ngjyrë kafe, i sjellë nga Afrika apo Azia. Përkthyesi.

<sup>11</sup> Aludim në ajetin 79 nga kaptina *En-Naziat* në Kuran. Përkthyesi.



Nuk i ikte kurrë namazi i xhumasë e as namazi me xhemat. E kishte mësuar Kuranin përmendsh, madje në një punim kishte përmbledhur dyzet hadithe me komentim.

E tërë kjo punë, pas ndihmës së Allahut, u arrit falë angazhimit të një njeriu të vetëm, të varfër e të izoluar, por që ishte pushtuar nga besimi, që ishte dominuar nga ideja, që ishte ngjitur e varur për qëllimet fisnike, aq sa nuk ishte më vetvetja dhe nuk mund të ndryshonte qëndrimin e tij (ishte shkrirë i tëri në besim). Ai i bindi mbretërit se nuk synonte pasurinë dhe postin e tyre, përkundrazi, iu tha se, nëse ata do të përmirësoheshin, ata ishin më meritoret për këto poste. Nuk bëhem rival në pushtetin tuaj, por e lus Allahun që t'ju japë sukses! Timonin (ose sipas shprehjeve të kohës: frerët) e shtetit e keni në duart tuaja. Zbatoni normat fetare dhe drejtohuni me këtë vend nga Islami!

Këta dy faktorë janë me rëndësi jetike për burrat e davesë:

*I pari*, që t'ia kesh idenë, që të pushton e të dominon, dhe

*I dyti*, të mos kesh synime për përfitime materiale dhe karrieriste.

Me kaq po mjaftohem, duke shpresuar që kjo të jetë kumtim për dëgjuesit e vëmendshëm dhe të zgjuar, bijtë tanë, bijtë e Universitetit Islamik! Allahu na begatoftë të gjithëve me gjërat në të cilat është e mira për fenë dhe besimtarët!

Dhe fare në fund, do të kthehem të ripërsëris atë që dua të jetë motoja juaj: **Të gjymtohet kjo fe duke qenë unë gjallë?!**

Ves selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuh!

*Lutja jonë e fundit është: Falënderimi i takon  
Allahut, Zotit të botëve!*

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

28

En-Nedvi, Ebu-l-Hasen ali El-Haseni

Thirrja dhe thirrësi / Ebu-l-Hasen ali El-Haseni  
En-Nedvi ; përktheu Sedat Islami. – Prishtinë :  
Shembulli, 2018. - 68 f. ; 21 cm.

1. Islami, Sedat

**ISBN 978-9951-732-14-7**